

228_Tietoa eristyspäätöksen saanelle_1
[albania]

Informacione marrësit të vendimit për izolim

Te ju është konstatuar infeksioni me virusin korona COVID-19 andaj jeni urdhëruar të qëndroni në izolim. Qëllimi i izolimit është që të pengohet shpërndarja e infeksionit më tutje në njerëzit tjerë. Vendimi për izolim është bërë në bazë të Aktit infektiv.

Kohëzgjatja e izolimit ju tregohet pasi që të urdhnoheni të qëndroni në izolim. Te rastet me simptome të lehta, izolimi zakonisht zgjatë 7 ditë nga fillimi i simptomave dhe 14 ditë në rastet që kanë nevojë për trajtim spitalor të sëmundjes me koronavirusin. Para përfundimit të izolimit duhet të keni dy ditë pa simptome. Nëse infeksioni juaj është dëshmuar në testim dhe ju nuk keni simptome, izolimi zgjatë 7 nga dita e marrjes së testit.

Çka do të thotë izolimi?

Kohën e karantinës duhet ta kaloni në banesën e juaj. Duhet ti shmangen kontaktet e afërta me njerëzit tjerë dhe të qëndroni në banesën e juaj. Për shembull, nuk guxon të shkoni në vend të punës, në shkollë, në kopësht, në hobi, në shitore dhe as në barnatore sepse në këto vende është vështirë ti shmangeni kontaktit të afërt. Vizitorët nuk guxojnë të vijnë te ju dhe ushqimin duhet ta porositni në shtëpi.

Nëse askush nuk mund të ju sjellë ushqimin dhe barnat, mund të kontaktoni telefonin kujdestar të shërbimeve sociale me numrin 09 310 44400.

Për ta zvogluar rrezikun e infektimit duheni të qëndroni të ndarë edhe nga personat që banojnë në të njejtën amvisri me ju. Nëse është e mundur, është mirë të qëndroni në dhomën tjetër nga tjerët. Higjiena e mirë e duarve dhe kollitjes është me rëndësi.

Duhet ti shmangeni kontaktet me njerëz edhe atëherë kur për shembull shetitni qenin apo hudhni mbeturinat.

Kurimi i sëmundjes

Sëmundjen mund ta kuroni në shtëpi nëse simptomat i keni të lehta dhe nëse nuk i takoni grupit të rrezikuar. Mjeku familjar i shtëpisë së shëndetit ose mjeku i mjeksisë së punës vlerëson gjendjen e juaj dhe ju tregon rezultatin e testit të koronës. Deri sa jeni të sëmurë është me rëndësi të pushoni dhe të pini mjaftë lëngje/fluide. Kundër temperaturës dhe dhimbjeve mund të përdorni barnat që mirren pa reçetë nga barnatorja.

Nëse keni simptome serioze, si p.sh. gulçim dhe gjendja e përgjithëshme ju keqësohet, telefononi qendrën shëndetësore ose info-numrin e qytetit, t. 09 310 10024 (hapur çdo ditë nga ora 8-18). Në kohërat tjera telefononi Ndihmën kujdestare, t. 116 117. Në rastet që kërkojnë trajtim të menjëhershëm, p.sh. nëse keni dhimbje akute të gjoksit, telefononi numrin e emergjencës 112.

228_Tietoa eristyspäätöksen saanelle_1
[albania]

Këtë informacion do ta merrni edhe nëse fëmija juaj është sëmurar nga sëmundja e virusit korona. Nëse fëmija juaj ka ndonjë nga këto simptome, shkoni sa më shpejtë te mjeku – pa marrë parasyshë shkaktuesin e sëmundjes apo sëmundjes themelore.

- vështërsi me frymëmarrje
- lëkura është e ngjyrës blu apo gri
- fëmija nuk pin aq sa duhet
- fëmija ka vjellje të fuqishme apo të vazhdueshme
- fëmija nuk zgjohet dhe nuk reagon fare
- fëmija është aq i shqetësuar sa që nuk vie fare në krahë
- simptomet zhduken, por këthehen me temperaturë të lartë dhe me kollitje më të rëndë.

Kompenzimi i humbjes së pagës

Për shkak të humbjeve të shkaktuara nga izolimi keni drejtë të merrni mëditjet e sëmundjes infektive. Këto mund ti kërkonin nga Enti pensional kombëtar (Kela). Aplikacionit ia bashkangjitni vendimin për karantinë të shkruar nga ana e mjekut të sëmundjeve infektive të qytetit Helsinki. Vendimi për karantinë ju dërgohet automatikisht me letër ose me postë elektronike të mbrojtur. Aplikacionin duhet ta dërgoni në Kela brenda dy muajve nga dita kur jeni urdhëruar të qëndroni në karantinë.

Mëditjet e sëmundjes infektive kompenzojnë humbjet e pagës nga mungesat në punë të shkaktuara nga karantina. Mëditjet e punëtorit përcaktohen sipas pagave të cilat do ti kishte marrë nëse kishte qenë në punë. Mëditjet e ndërmarresit përcaktohen në bazë të të ardhurave YEL ose MYEL vjetore në kohën kur ka filluar të mungon nga puna. Prindi mbikqyrës i fëmijës së moshës nën 16 vjeçe ka të drejtë në mëditjet e sëmundjes infektive nëse fëmija është urdhëruar të qëndron në karantinë dhe prindi nuk mund të punon. Informacione tjera gjeni në adresën www.kela.fi/tartuntatauti.

Kontaktet e juaja të afërta do ti kontaktojnë për karantinë

Shërbimet epidemiologjike të Helsinkit do i regjistrojnë kontaktet e juaja të afërta dhe do caktojnë atyre kohëzgjatjen e karantinës. Kohëzgjatja e karantinës është 10 ditë nga dita e fundit e kontaktit të afërt me të sëmurin. Nëse në shtëpinë e juaj banojnë persona tjerë kohëzgjatja e karantinës është 2 javë nga fillimi i simptomëve të personit të sëmurë ose për personin pa simptome nga dita e bërjes së testit.

Izolimi duhet të respektohet

228_Tietoa eristyspäätöksen saanelle_1
[albania]

Urdhëri i zyrtarit të sëmundjeve infektive për izolim duhet të respektohet gjithësesi. Sipas Ligjit të Finlandës për shkeljen e izolimit, edhe nëse me veprimin e juaj nuk infektoni askend, mund të denoheni me xhobë për shkeljen e masave mbrojtëse shëndetsore ose me denim burgimi deri në tre muaj burg.